


Strategjisë lokale për të rinjtë e Komunës së Butelit 2023-2028



Strategjia lokale për të rinjtë

**e Komunës së Butelit
2023-2028**



Проектот е финансиран
од Европската Унија



Botues:

Eurothink – Qendra për strategji europiane – Shkup

Rreth botuesit:

Dimitar Nikollovski, Drejtor eksekutiv

E pëpunoi:

Grupi i punës për përpilimin e Strategjisë lokale për të rinjtë të Komunës së Butelit
2023 - 2028

Rregullimi grafik:

Ivana Mirçevska

Përktheu:

Behar Rushit

Lektura:

Suhejb Mustafa

Korrik, viti 2023.

Ky publikim është pjesë e proejtktit “Komuna e Butelit e hapur për të rinjtë”, i cili finansohet nga programi i granteve të projektit “Pjesëmarrja rinore për zhvillim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm për komunitetin” i finansuar nga BE dhe i zbatuar nga Koalicioni për shoqata rinore SEGA. Për përmbajtjen e këtij publikimi, Eurothink – Qendra për strategji europiane, Shkup është krejtësisht i përgjegjshëm dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.



СОДРЖИНА

Përmbajtja	5
QASJA GJATË PËRPILIMIT TË STRATEGJISË	6
PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJENDJES SË TË RINJVE NË KOMUNËN E BUTELIT DHE NEVOJA PËR PËRPILIMIN E STRATEGJISË LOKALE PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË BUTELIT 2023-2028 (KONTEKSTI)	7
Qëllimi dhe fushat tematike	9
1. Pjesëmarrja e të rinjve	9
2. Cilësia e të jetuarit	11
3. Kultura	12
4. Informimi i të rinjve	13
Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit	15
Plani i Veprimit i Strategjisë lokale për të rinjtë 2023 - 2028.....	16
GJETJET E ANALIZËS SË REALIZUAR PËR NEVOJAT E TË RINJVE NË KOMUNËN E BUTELIT	23
Analiza e të dhënave të kërkimit sasior	23
Fusha tematike - Arsimi	27
Fusha tematike - Punësimi dhe mbështetja para punësimit	29
Fusha tematike - Pjesëmarrja e të rinjve dhe informimi i të rinjve	32
Fusha tematike - Sporti	37
Fusha tematike - Shëndetësia	39
Fusha tematike - Cilësia e të jetuarit	41
Fusha tematike - Kultura	44
Fusha tematike - Puna lokale rinore	46
Analiza e të dhënave nga hulumtimi cilësor – grupet e fokusit	47
Grupi i Punës	50

HYRJE

Organizata civile “Eurothink” – Qendra për Strategji Europiane ka zbatuar projektin “Komuna e Butelit e hapur për të rinjtë”, i financuar nga Bashkimi Europian në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e të rinjve për zhvillim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm të bashkësisë”. Ky projekt është i realizuar nga “Koalicioni i organizatave rinore SEGA”.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në mundësimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në zbatimin e politikave lokale rinore dhe në vendimmarrje për çështje dhe probleme që i prekin ose janë me interes për të rinjtë në nivel të Komunës së Butelit. Kështu, përforcimi i kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal si dhe të administratës komunale dhe anëtarëve të Këshillit të Komunës së Butelit për të krijuar, realizuar dhe monitoruar zbatimin e politikave rinore dhe rritjen e interesit dhe motivimit, si dhe përforcim të kapaciteteve të grupeve të prekura të të rinjve në territorin e komunës (për pjesëmarrje aktive qytetare dhe rinore në nivel lokal dhe kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm të bashkësisë lokale), janë pozicione qëllimore fillestare sinergjike që çojnë në qëllimin e përgjithshëm dhe përfundimtar, e që është mundësimi dhe nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në realizimin e politikave lokale rinore në Komunën e Butelit.

Një nga aktivitetet e këtij projekti ishte ndihma e Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Butelit për të krijuar Strategjinë rinore lokale 2023 - 2028, përgatitja e së cilës do të realizohet përmes bashkëpunimit të përbashkët të këshillit, grupit të punës dhe “Eurothink”-ut si koordinator i projektit.

QASJA GJATË PËRPILIMIT TË STRATEGJISË

Si bazë për përgatitjen e këtij dokumenti është realizuar një anketë, e cila ka përfshirë të rinjtë në komunën e Butelit dhe aktorët përkatës. Hulumtimi siguroi të dhëna dhe pasqyrë mbi gjendjen dhe nevojat e të rinjve në komunë në tetë fusha parësore, të përcaktuara në Strategjinë nacionale rinore. Në bazë të hulumtimit, u përzgjedhën fokuset tematike të strategjisë dhe u nxorën përfundime, qëllime, plan veprimi dhe rekomandime për secilën nga fushat tematike të përzgjedhura.

Hulumtimi sasior është realizuar përmes një ankete onlajn, aktive në periudhën 14 janar – 1 mars 2023, në të cilën kanë marrë pjesë 231 të anketuar nga Komuna e Butelit, nga mosha 15 deri në 29 vjeç.

Hulumtimi cilësor u krye duke realizuar tre fokus grupe (me përbërje të përzier), me gjithsej 18 pjesëmarrës nga tre grupet e synuara:

- persona të rinj (15 -29 vjeç)
- përfaqësues të kuadrit mësimor nga shkollat fillore dhe të mesme në komunë
- përfaqësues të organizatave rinore dhe përfaqësues të Komunës së Butelit

Intervistat e fokus grupeve u zhvilluan në platformën onlajn ZOOM. Intervista e parë me fokus grupin u mbajt më 1 mars 2023, e dyta më 9 mars 2023. dhe e treta më 17 mars 2023.

Në kuadër të hulumtimit janë realizuar edhe takime konsultative me shoqatat rinore, me përfaqësues të sektorit joqeveritar dhe me përfaqësues të rinisë së partive politike.

Në kuadër të komunës ekzistojnë disa organizata dhe shoqata joqeveritare, ndër të cilat më aktive është “OJQ Interkultura”. Pjesëmarrësit nga “OJQ Interkultura” u ftuan të marrin pjesë në zhvillimin e strategjisë dhe të kontribuojnë me përvojat dhe njohuritë e tyre. Më tej, u zhvilluan takime me organizata dhe shoqata rinore dhe të shkollave të mesme, si Forumi Arsimor Rinor dhe Unioni i Gjimnazistëve, ndihma logjistike e të cilëve ishte e një rëndësie të madhe. Në kuadër të projektit (pjesë e të cilit është edhe kjo strategji), janë mbajtur dy trajnime me përfaqësues nga komuna, ku janë marrë edhe njohuri të vlefshme për drejtimet në të cilat duhet të drejtohet komuna.

Në procesin konsultativ ishin të përfshirë edhe përfaqësuesit e partive politike me grupet më të mëdha rinore - LSDM dhe VMRO-DPMNE. Qasja aktiviste-vullnetare ndaj shoqërisë të të rinjtë në Butel përgjithësisht kuptohet përmes pjesëmarrjes në formacionet dhe organizatat rinore partiake, ndaj ishte e rëndësishme që të merret parasysh edhe kjo palë e prekur, e cila dha një kontribut të rëndësishëm.

Në procesin e hartës së partnerëve potencialë strategjikë u evidentuan mbi 18 shoqata, përfaqësues të organizatave dhe lëvizjeve, përfaqësues të partive politike dhe individëve, klubeve sportive etj., me të cilët u bënë kontakte dhe të cilëve iu prezantua projekti në

drejtim të bashkëpunimit të mundshëm. Bashkëpunimi u pranua nga të gjitha palët, veçanërisht në zbatimin e përmbajtjes së informacionit shpërndarës logjistik të projektit, por edhe ndihmë në përzgjedhjen e përfaqësuesve rinorë, vullnetarëve dhe aktivistëve me përvojë, të cilët mund të kontribuojnë sipas mundësive të tyre.

Në këtë mënyrë në krijimin e Strategjisë lokale për të rinjtë të Komunës së Butelit 2023-2028 janë përfshirë të gjithë faktorët përkatës, të cilët me përgjigjet, mendimet dhe sugjerimet e tyre ndihmuan në krijimin e kësaj strategjie.

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJENDJES SË TË RINJVE NË KOMUNËN E BUTELIT DHE NEVOJA PËR PËRPILIMIN E STRATEGJISË LOKALE PËR TË RINJTË E KOMUNËS SË BUTELIT 2023-2028 (KONTEKSTI)

Komuna e Butelit është pjesë e komunave të Qytetit të Shkupit, e cila është themeluar në vitin 2005 në pajtim me Ligjin e Ndarjes Territoriale nga viti 2004. Ndahet në disa vendbanime urbane dhe rurale, prej të cilave vendbanime urbane janë: Butel 1 dhe Butel 2, Shkup Veri, Radishanë dhe Rruga e Lubotenit. Ndërsa vendbanimet rurale janë: Lubancë, Vizbeg, Radishanë dhe Luboten. Sipas regjistrimit të vitit 2021, numri i përgjithshëm i të rinjve që jetojnë në komunën e Butelit është 7401 banorë, nga të cilët 3804 janë meshkuj dhe 3597 femra.

Në Komunën e Butelit ekzistojnë shtatë shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme që janë nën kompetencën e Komunës së Butelit. Shkollat fillore janë: Sh.F. “Aco Shopov” - Radishanë, Sh.F. “Goce Dellçev” - Lubancë, Sh.F. “Zhivko Brajkovski” - Butel, Sh.F. “Kliment Ohridski” - Butel, Sh.F. “Liman Kaba” - Luboten, Sh.F. “Panajot Ginovski” - Butel, Sh.F. “Petar Zdravkovski Penko” - Butel. Ndërsa shkollat e mesme janë: ShMQSh Gjumnazi “Zef Lush Marku” - Shkup dhe ShMEJQSh “Arseni Jovkov” - Shkup. Shkollat fillore dhe të mesme janë një nga faktorët kryesor institucional ku të rinjtë socializohen dhe formohen si individë. Në këtë drejtim, nxënës dhe mësimdhënës nga disa shkolla janë përfshirë në hartimin e Strategjisë lokale për të rinjtë, për të marrë më shumë informacione për nevojat e të rinjve në komunë.

Sa i përket socializimit të të rinjve në Komunën e Butelit, më së shumti bëhet në shkolla, nëpër objektet sportive në komunë, si dhe në tubime joformale nëpër kafene, parqe etj. Në kuadër të komunës ende nuk ka qendra aktive rinore dhe organizata rinore që ndikojnë në përmirësimin e socializimit të të rinjve.

Për të përmirësuar cilësinë e të jetuarit të të rinjve, Strategjia lokale për të rinjtë e Komunës së Butelit 2023-2028 parasheh analizë të situatës në nëntë fusha tematike, të cilat janë

të një rëndësie kyçe për të rinjtë, duke marrë parasysh se kushtet në ato fusha tematike pasqyrojnë në fakt cilësinë e të jetuarit të të rinjve, si dhe dëshirat dhe kërkesat e tyre për atë që duan të shohin në të ardhmen.

Fushat tematike që janë hulumtuar janë:

- Arsimi
- Punësimi dhe mbështetja para punësimit
- Informimi i të rinjve
- Pjesëmarrja e të rinjve
- Sporti
- Shëndetësia
- Cilësia e të jetuarit
- Kultura
- Puna rinore lokale

Qëllimi dhe fushat tematike

Qëllimi i Strategjisë lokale për të rinjtë të Komunës së Butelit 2023-2028 është të sigurojë një kornizë për të mundësuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në zbatimin e politikave lokale rinore dhe vendimmarrjen për çështjet rinore.

Bazuar në këtë premisë fillestare dhe në bazë të analizës së kryer të tetë fushave parësore (të përcaktuara në Strategjinë nacionale për rininë), grupi i punës zgjodhi katër fushat parësore të mëposhtme për fokus:

- Pjesëmarrja e të rinjve
- Cilësia e të jetuarit
- Kultura
- Informimi i të rinjve

1. PJESËMARRJA E TË RINJVE

Pjesëmarrja e të rinjve nënkupton të drejtën dhe mundësinë që të rinjtë të përfshihen aktivisht në të gjithë procesin e krijimit, miratimit dhe realizimit të politikave që lidhen me ta. Krijimi i mundësive për angazhimin e tyre është një supozim bazë për krijimin e politikave të mira lokale për rininë.

Anketa e kryer tregoi se vetëm 26.2% e të anketuarve kanë marrë ndonjëherë pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe/ose shtetëror. Shumica prej tyre e kanë arritur këtë përmes anëtarësimit në një organizatë rinore/të shkollës së mesme/studentore (8.7%), pastaj përmes anëtarësimit në parti politike (6.5%) dhe anëtarësimit në një organizatë joqeveritare (5.2%). 62.8% deklaruan se nuk kishin ndërmarrë kurrë një aktivitet të tillë.

Pjesëmarrja e të rinjve është një nga fushat që do të kërkojë investim më të madh nga Këshilli Rinor Lokal në Komunën e Butelit. Në të kaluarën, këshillat kanë funksionuar me kapacitete të pjesshme, ndër të tjera, për shkak se buxhetet vjetore të Komunës nuk parashikonin mjete për Këshillin Rinor Lokal. Një nga pikat strategjike më të rëndësishme për përmbushjen e kësaj strategjie është pikërisht miratimi i buxhetit.

Prioriteti: Pjesëmarrja e të rinjve

Qëllimi: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në marrjen e vendimeve për politika dhe programe që ndikojnë drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt në jetën e të rinjve, përmes institucioneve dhe nismave formale dhe joformale në kuadër të Komunës.



Qëllimi specifik 1:

Të miratojë buxhet Këshilli Komunal për Këshillin Rinor Lokal

Strategjitë:

- Të krijohet një Këshill Rinor Lokal, i cili do të jetë funksional dhe i miratuar në mënyrë demokratike dhe pjesëmarrëse.
- Zbatimi i qëndrueshëm, efektiv dhe efikas i Ligjit të Pjesëmarrjes Rinore dhe Politikave Rinore, duke forcuar mbikëqyrjen mbi zbatimin e tij. Të organizohen takime të Këshillit Rinor Lokal, Zyrës për Rininë dhe këshilltarëve të Komunës së Butelit, të cilat do t'i referohen buxhetit dhe aktiviteteve të KRL-së.
- Fuqizimi i kapaciteteve të komunave dhe i Qytetit të Shkupit për zbatimin e strategjive lokale për rininë, si dhe për mbështetjen e këshillave rinore lokale.



Qëllimi specifik 2: Rritja e bashkëpunimit të Komunës së Butelit me institucionet dhe organizatat që zhvillojnë programe për të rinjtë, për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Strategjitë:

- Organizimi i takimeve me organizatat aktive që veprojnë në kuadër të Komunës së Butelit dhe krijimi i përbashkët i një platforme për veprimtari të përbashkët.
- Mbajtja e debateve publike lidhur me problemet e të rinjve në Komunë.
- Organizimi i prezantimeve mbi aktivizmin rinor dhe vullnetarizmin.

2. CILËSIA E TË JETUARIT

Kategoria e dytë që ra në sy në të gjitha marrëdhëniet formale-analitike (fokus grupe dhe pyetësor onlajn) dhe joformale (trajtime dhe konsultime), është fusha parësore e cilësisë së jetës.

19.5% e të rinjve në Butel vlerësojnë se jeta në këtë komunë është “e mirë”, 48.5% “deri diku e mirë”, 17.7% “deri diku e keqe” dhe 11.3% “e keqe”. Kjo tregon se 68% e të anketuarve kanë perceptim pozitiv për cilësinë e jetës në Komunën e Butelit.

Punësimi dhe përmirësimi i standardit të jetesës është një nga arsyt më të zakonshme që të anketuarit besojnë se do të përmirësonte cilësinë e jetës së tyre, me 26.4%. Më pas vijon jeta shoqërore me 11.7%, kushtet për arsim dhe avancim profesional me 9.5%, lufta kundër krimit dhe korrupsionit me 9.1%.

Një aspekt i rëndësishëm është aspekti i sigurisë, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se Komuna e Butelit është një nga pikat kritike të dhunës në komunikacionin publik, e cila është një manifestim i mosdurimit ndëretnik. Pothuajse në të gjitha rastet e tilla, autorë dhe viktimë janë nxënësit e shkollave të mesme (15-19 vjeç) nga Komuna e Butelit. Anketa tregoi se 25.5% e të rinjve ndjehen të sigurt në komunën e Butelit, dhe 42.4% ndjehen deri diku të sigurt - përmbledhtazi, 67.9%. Në të kundërt, 13.9% ndihen deri diku të pasigurt dhe 16.9% nuk ndihen të sigurt - përmbledhtazi 30.8%. Shkaktarët kryesorë të pasigurisë janë krimi dhe grupet kriminale, qentë endacakë, jotoleranca ndëretnike, armëmbajtja pa leje, joefikasiteti i policisë etj.

Prioriteti: Cilësia e të jetuarit

Qëllimi: Rritja e sigurisë në hapësirën publike në Komunë

Qëllimi specifik 1: Zvogëlimi i dhunës në transportin publik (autobusë).

Strategjitë:

- Organizimi i debateve me përfaqësues të NQP-së, MPB-së, Këshillit të Komunës së Butelit, OJQ-ve dhe KRL-së për të identifikuar problemet që lidhen me sigurinë në transportin publik dhe gjetjen e mënyrave për tejkalimin e saj.
- Në bashkëpunim me MPB-në, realizimi i një fushate për sensibilizimin e dhunës në shkollat fillore dhe të mesme.
- Krijimi i një sistemi për regjistrimin e dhunës së bashkëmoshatarëve.

☉ **Qëllimi specifik 2: Rritja e besimit të të rinjve në dimensionin e sigurisë, gjatë shfrytëzimit të hapësirës publike (transport publik, parqe dhe rrugë).**

Strategjitë:

- MPB-ja të publikojë një buletin të akteve të dënueshme të dhunshme në transportin publik dhe ai të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Butelit.

3. KULTURA

Fusha e tretë e për zgjedhur është kultura. Kultura luan një rol kyç në procesin e socializimit të të rinjve, duke i bërë ata qytetarë të sigurt në vetvete, të përgjegjshëm për shoqërinë dhe aktivë. Konsiderohet si një platformë përmes së cilës bëhet e mundur tejkalimi i disa prej sfidave të sotme. Të rinjtë duhet të marrin pjesë në organizimin e ngjarjeve kulturore, veçanërisht ato të natyrës gjithëpërfshirëse. Domethënë, qëllimi është që grupet e ndryshme etnike, fetare dhe kulturore në Butel të bashkëpunojnë dhe të njihen me njëri-tjetrin. Kultura luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e të rinjve, duke i bërë ata qytetarë të emancipuar, të kënaqur, të sigurt në vetvete dhe të angazhuar në shoqëri.

Një e treta e të anketuarve konsiderojnë se gjendja e kulturës dhe e ofertës kulturore në Komunën e Butelit është deri diku e mirë. Përmbledhtazi, 50.6% e të anketuarve kanë qëndrim pozitiv ndaj kësaj çështjeje, ndërsa 39.4% e konsiderojnë situatën të keqe ose deri diku të keqe. Problemi kryesor është mungesa e ofertës kulturore (11.7%) dhe 4.8% mendojnë se nuk po investohet mjaftueshëm për të përmirësuar situatën. Përndryshe, të rinjtë janë më të interesuar të ndjekin koncerte muzikore, shfaqje kinemaje dhe shfaqje teatrore.

Prioriteti: Kultura

Qëllimi: Rritja e mundësive për të rinjtë për të marrë pjesë në krijimin e politikave kulturore gjithëpërfshirëse në nivel lokal, me synim ngritjen e ofertës kulturore brenda Komunës së Butelit.

☉ **Qëllimi specifik 1: Të rritet atraktiviteti i ngjarjeve kulturore te të rinjtë, përmes rritjes së përfshirjes dhe konsultimit të të rinjve në planifikimin dhe zbatimin e tyre.**

Strategjitë:

- Përfshirja e organizatave rinore dhe e Këshillit Lokal Rinor të Komunës së Butelit në aktivitetet për planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e ofertës kulturore në Komunën e Butelit.
- Organizimi i ngjarjeve kulturore verore rinore.

 **Qëllimi strategjik 2: Të rritet oferta kulturore në forma që do të parashikojnë një parim gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes, për të tejkaluar marrëdhëniet stereotipike dhe konfliktuale mes të rinjve në komunë.**

Strategjitë:

- Nisma të veçanta për përfshirjen e të rinjve me më pak mundësi, për qasje në ngjarje dhe programe kulturore që do të udhëhiqeshin nga Komuna e Butelit dhe organizatat qytetare që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes.
- Inkurajimi i komunës për të krijuar një infrastrukturë kulturore për të rinjtë, nëpërmjet zhvillimit të partneriteteve publike-private me organizatat qytetare, shoqatat dhe aleancat e të rinjve që operojnë në fushën e kulturës.
- Organizimi i manifestimeve kulturore multi-etnike, me qëllim të njohjes së ndërsjellë dhe bashkëpunimit kulturor.

4. INFORMIMI I TË RINJVE

Informimi i të rinjve është i lidhur ngushtë me pjesëmarrjen e të rinjve, duke marrë parasysh se qasja e lirë dhe transparente në informacione cilësore, të vërteta dhe në kohë ndikon në vendimet e të rinjve dhe nëse ata do të japin një kontribut aktiv për bashkësinë. Informimi për të rehat në Komunë, por edhe aspekte të tjera lidhur me mundësitë e të rinjve për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe ndryshimet e mundshme në shoqërinë ku jetojnë, mungon në Komunë si opsion për të rinjtë. Një nga tezat bazë të kësaj strategjie është se mungesa e praktikës së shkëmbimit të informacionit të dobishëm për të rinjtë pengon përfshirjen e tyre aktive në proceset e vetëqeverisjes lokale, por edhe në sektorë të tjerë.

52.4% e të rinjve deklaruan se nuk janë të informuar për mundësitë e të rinjve, të cilat mund t'i marrin përmes formave të organizimit të të rinjve, kundrejt 39% që i njohin këto mundësi. Shumica e të anketuarve janë të informuar onlajn, d.m.th. përmes mediave sociale

(67,5 %), përmes portaleve të internetit (17,7 %) dhe më së shumti janë të interesuar për informacione të natyrës argëtuese (19,5 %), ngjarje botërore (16,5 %), pastaj ekonomi dhe biznes (14,7%) dhe për informacione për zhvillimet shoqërore dhe politike në vend (14,3%). Gjithashtu, 26.4% e të anketuarve besojnë se në komunën e Butelit bëhen politika të mira për të rinjtë, ndërsa 41.1% nuk mendojnë se në komunë bëhen politika të mira.

Prioriteti: Informimi i të rinjve

Qëllimi: Krijimi i mekanizmave dhe/ose formave për informim përmes përmbajtjeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për të rinjtë, të cilat lidhen me prioritetet e përcaktuara në këtë strategji.

 **Qëllimi specifik 1: Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet vetëqeverisjes lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe subjekteve të tjera juridike që zhvillojnë programe rinore.**

Strategjitë:

- Thirrje dhe ftesa për të gjitha palët e interesuara (OJQ, KRL, organizata rinore nga partitë politike).
- Inkurajimi i dialogut ndërmjet mediave, të rinjve dhe formave të organizimit të të rinjve.
- Krijimi i bazës së të dhënave të informacionit në lidhje me të rinjtë.
- Fillimi i një nisme për një Qendër Informative Rinore.

 **Qëllimi specifik 2: Përdorimi i platformave të internetit dhe i aplikacioneve për telefonat inteligjentë, si mjet për informimin e të rinjve**

Strategjitë:

- Përdorimi i internetit dhe ngritja e një aplikacioni të përshtatshëm për informacion.
- Krijimi i profileve të veçanta Fejsbuk, Instagram dhe Tiktok.
- Mirëmbajtja dhe përditësimi i të dhënave dhe informacionit.
- Hartimi i një plani komunikimi të Komunës së Butelit, për rrjedhjen e informacionit tek të rinjtë.

Qëllimi specifik 3: Forcimi i kapaciteteve të të rinjve për njohjen e dezinformatave, përmirësimi i edukimit mediatik dhe mendimi kritik te të rinjtë.

Strategjitë:

- Mbështetja financiare e projekteve në partneritet me format e organizimit të të rinjve që kanë të bëjnë me edukimin mediatik dhe digjital, për njohjen e dezinformatave.
- Shfrytëzimi i praktikave të mira nga projektet ekzistuese, të zbatuara nga format e organizimit të të rinjve dhe shoqatat e tjera profesionale, me fokus në edukimin mediatik.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit

Zbatimi i strategjisë është i një rëndësie thelbësore për të rinjtë në Komunën e Butelit. Në këtë strategji të zhvilluar për periudhën 5-vjeçare, paraqiten në mënyrë të përmbledhur problemet dhe sfidat me të cilat përballen në katër fushat parësore.

Për të zbatuar me sukses këtë strategji dhe për të monitoruar procesin e zbatimit të qëllimeve të parapara strategjike, është e rëndësishme të krijohet një trup pune që do të monitorojë procesin e zbatimit. Ai organ do të ishte përgjegjës jo vetëm për monitorimin, por edhe për koordinimin e prioritetëve dhe qëllimeve strategjike. Rekomandimi duhet të përbëhet nga këshilltarët nga Komuna e Butelit, nga Zyra për Rininë, një anëtar i Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Butelit dhe një anëtar i një organizate joqeveritare (e cila merret me politikën rinore në kuadër të Komunës së Butelit ose Qytetit të Shkupit). Trupi punues duhet të përgatisë një metodologji për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit, të përgatisë raporte periodike për zbatimin, të cilat do të jenë publike në ueb faqen e Komunës së Butelit. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që sektori civil të angazhohet aktivisht në monitorimin e zbatimit.

Plani i Veprimit i Strategjisë lokale për të rinjtë 2023 - 2028

Prioriteti: PJESËMARRJA E TË RINJVE

Qëllimi i prioritetit: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në institucione dhe nisma formale dhe joformale në kuadër të komunës

Qëllimi specifik nr. 1

Të miratohet buxheti nga Këshilli Komunal për Këshillin Rinor Lokal

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Të formohet Këshilli Rinor Lokal, i cili do të jetë funksional dhe do të miratohet në mënyrë demokratike dhe pjesëmarrëse.	Këshill Rinor funksional	Mbledhje e mbajtur	Korrik - shtator 2023	Komuna e Butelit
Mbajtja e seancës konstituive të Kuvendit Lokal të Rinisë;		Dokument zyrtar	Korrik 2023	Këshilli i Komunës së Butelit
Thirrje për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Rinor Lokal;		Dokument zyrtar	Gusht 2023	Këshilli i Komunës së Butelit
Verifikimi i anëtarëve të KRL-së nga Këshilli i Komunës së Butelit		Dokument zyrtar	Gusht 2023	Këshilli i Komunës së Butelit
Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KRL-së dhe miratimi i Rregullores së punës		Dokument zyrtar	Shtator 2023	Këshilli i Komunës së Butelit
Str.2: Të organizohen mbledhje të Këshillit Rinor Lokal, Zyrës së të rinjve dhe këshilltarëve të Komunës së Butelit, që kanë të bëjnë me buxhetin dhe aktivitetet e KRL-së.	Të miratohet buxheti vjetor për vitin 2024 për KRL-në e Komunës së Butelit	Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura	Shtator - dhjetor 2023	KRL Butel
Dërgimi i ftesave me e-mail për të gjithë këshilltarët dhe caktimi i një takimi për të diskutuar miratimin e buxhetit	Këshilli i Komunës së Butelit	Ftesa (e-maile)	Shtator 2023	KRL-ja e Komunës së Butelit
Organizimi dhe mbajtja e takimeve të KRL-së me përfaqësuesit e grupeve këshillimore të Komunës së Butelit	Të përpilohet dhe dërgohet propozim projekti për financim	Lista e të pranishmëve	Shtator-tetor 2023	Shtator-tetor 2023

Qëllimi specifik nr. 2

Të rritet bashkëpunimi i Komunës së Butelit me institucionet dhe organizatat që zhvillojnë programe për të rinjtë, për realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Organizimi i takimeve me organizatat aktive që veprojnë në kuadër të Komunës së Butelit dhe krijimi i përbashkët i një platforme për veprim të përbashkët				
Dërgimi i e-maileve tek organizatat dhe i ftesave për takime	Të nënshkruhet memorandum bashkëpunimi me shoqatën	Numri i memorandumëve Programi i punës	Janar – shkurt 2024	Komuna e Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit Shoqatat e qytetarëve
Mbajtja e takimeve me organizata aktive joqeveritare	Të nënshkruhet memorandum bashkëpunimi me shoqatën Të zbatohen projektet e përbashkëta për të rinjtë	Numri i projekteve të realizuara	Janar – mars 2024	KRL-ja e Komunës së Butelit Shoqatat e qytetarëve
Str.2: Mbajtja e debateve publike lidhur me problemet e të rinjve në komunë				
Tribuna dhe promovime për pjesëmarrjen e të rinjve	Të rinjtë të jenë të informuar dhe të përfshirë në aktivitete rinore	Numri i tribunave të mbajtura	Shtator 2024	Këshilli Rinor Shoqatat e qytetarëve
Str.3: Organizimi i prezantimeve mbi aktivizmin rinor dhe vullnetarizmin				
Bashkëpunimi me shkollat e komunës	Të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi me shkollën e komunës Hapësirë të përcaktuar dhe të vërtetuar për punë dhe veprimtari	Numri i shkollave të përfshira Numri i memorandumëve Korniza kohore për shfrytëzimin e hapësirës	Shtator 2024	Komuna KRL-ja e Komunës së Butelit Shoqatat e qytetarëve
Programi i aktiviteteve për të rinjtë	Aktivitete të realizuara për të rinjtë përmes metodave informale të punës dhe edukimit	Numri i të rinjve të përfshirë Numri i aktiviteteve të realizuara	Shtator - nëntor 2024	Këshilli Rinor Shoqatat e qytetarëve

Prioriteti: Cilësia e të jetuarit

Qëllimi i prioritetit: Rritja e sigurisë në hapësirat publike të komunës

Qëllimi specifik nr. 1				
Zvogëlimi i dhunës në transportin publik (autobusë)				
Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Organizimi i disa debateve me përfaqësues të NQP-së, MPB-së, Këshillit të Komunës së Butelit, OJQ -ve dhe KRL-së për lokalizimin dhe tejkalimin e problemeve që lidhen me sigurinë në transportin publik.				
Ftesa për MPB-në, NQP-në, Këshillin e Komunës së Butelit, kryetarin e Komunës së Butelit, përfaqësues të partive politike	Pjesëmarrje në debat	Numri i institucioneve të përfshira	Nëntor 2024 - Janar 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit
Organizimi dhe mbajtja e një debati në Komunën e Butelit lidhur me dhunën në transportin publik	Konkluzione dhe platforma për ballafaqimin me dhunën	Numri i institucioneve të përfshira Numri i të rinjve të përfshirë	Shkurt-mars 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit Komuna e Butelit
Str.2: Në bashkëpunim me MPB-në është nisur një fushatë me një sërë ligjëratash për ngritjen e vetëdijes mbi dhunën në shkollat fillore dhe të mesme.				
Memorandum bashkëpunimi me MPB-në	Memorandum	Të rinj të përfshirë	Gjatë vitit 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit MPB NQP
Memorandum bashkëpunimi me OJQ-të që merren me dhunën te të rinjtë	Memorandum	Organizata joqeveritare të përfshira Numri i vendeve Numri i të rinjve	Gjatë vitit 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit Shoqata të qytetarëve
Mbajtja e ligjëratave për ngritjen e vetëdijes lidhur me dhunën në transportin publik	Ligjëratat publike në shkollat	Numri i vendeve Numri i të rinjve	Gjysmëvjetori i vitit 2025	Këshilli Rinor, ShQ

Qëllimi specifik nr.2

Rritja e besimit të të rinjve në dimensionin e sigurisë gjatë përdorimit të hapësirave publike (transport publik, parqe dhe rrugë)

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.3: MPB-ja të publikojë buletin e akteve të dënueshme të dhunës në transportin publik dhe ato të publikohen edhe në faqen zyrtare të Komunës së Butelit.				
Marrja e përmbytjeve nga MPB-ja - Çair lidhur me Komunën e Butelit dhe ripublikimi në platformat sociale të KRL-së së Komunës së Butelit	Përmbytje për dhunues të dënuar	Gjithsej përmbytje të publikuara	2025 2026 2027 2028	KRL-ja e Komunës së Butelit MPB

Prioriteti: Kultura

Qëllimi i prioritetit: Rritja e mundësive të të rinjve për t'u përfshirë në organizimin dhe krijimin e nismave kulturore për të ngritur ofertën kulturore në kuadër të Komunës së Butelit.

Qëllimi specifik nr. 1

Të rritet atraktiviteti i ngjarjeve kulturore të të rinjtë përmes rritjes së përfshirjes dhe konsultimit të të rinjve në planifikimin dhe realizimin e tyre

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Përfshirja e organizatave rinore dhe Këshillit Rinor Lokal të Komunës së Butelit në aktivitetet për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e ofertës kulturore në Komunën e Butelit				
Takime informuese të komunës me organizatat joqeveritare dhe KRL-në e Komunës së Butelit	Realizim i bashkëpunimit me OJQ-të	Numri i takimeve Numri i ShQ-ve dhe i institucioneve	Mars 2025 – nëntor 2026	KRL-ja e Komunës së Butelit OJQ
Krijimi i një regjistri të ideve për manifestime dhe ngjarje kulturore që janë të qasshme onlajn	Regjistri i ideve	Gjithsej numri i ideve	Mars 2025 – mars 2026	JKRL-ja e Komunës së Butelit OJQ
Str.2: Organizimi i manifestimeve rinore kulturore verore				
Organizimi i 4 ngjarjeve në periudhën verore në vitin 2025, 2026, 2027	12 manifestime kulturore (nga 4 në vit)	Data konkrete për mbajtjen e ngjarjeve	2025 2026 2027	KRL-ja e Komunës së Butelit Këshilli i Komunës së Butelit

Qëllimi specifik nr. 2

Të rritet oferta kulturore në forma që do të parashikojnë një parim gjithëpërfshirës të pjesëmarrjes, për të kapërcyer marrëdhëniet stereotipike dhe konfliktuale mes të rinjve në komunë

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Nisma të veçanta për përfshirjen e të rinjve me më pak mundësi për të marrë pjesë në ngjarjet dhe programet kulturore që do të drejtoreshin nga Komuna e Butelit dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e gjithëpërfshirjes				
Financimi dhe mbështetja e programeve të veçanta për përfshirjen e të rinjve me më pak mundësi në aktivitete kulturore		Është përgatitur një koncept për projektet e përfshirjes së të rinjve përmes kulturës	2025 2026 2027	Komuna e Butelit Këshilli i Komunës së Butelit Institucione nga fusha e përfshirjes sociale dhe kulturore
Krijimi i një udhëzuesi për organizimin e ngjarjeve gjithëpërfshirëse kulturore		Përgatitja e udhëzuesit	Korrik – dhjetor 2024	Komuna e Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit Institucione nga fusha e përfshirjes sociale dhe kulturore
Str.2: Organizimi i ngjarjeve kulturore multietnike me qëllim të njohjes së ndërsjellë dhe bashkëpunimit kulturor				
Organizimi i një ngjarjeje kulturore në vit me përmbajtje dhe karakteristika të larmishme etnike	Gjithsej 4 ngjarje	Gjithsej 4 ngjarje Numri i pjesëmarrësve të bashkësive të ndryshme etnike	2024 2025 2026 2027	Komuna e Butelit Këshilli i Komunës së Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit OJQ Të rinj të partive politike
Organizimi i debateve (një në vit) në lidhje me përfitimet e bashkëpunimeve të përbashkëta kulturore	Gjithsej 4 ngjarje	Gjithsej 4 ngjarje Numri i pjesëmarrësve të bashkësive të ndryshme etnike	2024 2025 2026 2027	Komuna e Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit Të rinj të partive politike OJQ

Prioriteti: Informimi i të rinjve

Qëllimi i prioritetit: Krijimi i mekanizmave dhe/ose formave për informimin e të rinjve për interesat e të rinjve lidhur me prioritetet e tyre të përcaktuara në strategji

Qëllimi specifik nr.1:

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet vetëqeverisjes lokale, organizatave të shoqërisë civile dhe subjekteve të tjera juridike që zhvillojnë programe rinore

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Thirrje dhe ftesë për të gjitha palët e interesuara (OJQ, KRL, organizata rinore nga partitë politike)				
Dërgimi i ftesave për anëtarët e OJQ-ve, KRL-së dhe organizatave të tjera rinore dhe pjesëmarrësve të rinj në politikë	Nismë për mbledhje	Numri i ftesave të dërguara	Gusht 2024	KRL-ja e Komunës së Butelit
Organizimi i tribunave dhe mbledhjeve	Nismë për formimin e programit	Numri i ftesave të dërguara Numri i pjesëmarrësve Numri i tribunave	Qershor 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit
Krijimi i një dokumenti dhe programi të përbashkët	Programi i strategjisë informative për informimin e të rinjve		Korrik 2025 – korrik 2026	Komuna e Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit
Str.2: Krijimi i bazës së të dhënave të informacioneve lidhur me të rinjtë				
Platforma për ruajtjen e informacioneve me interes për të rinjtë	Krijimi i bazës së të dhënave, e cila do të jetë e qasshme për grupin e targetit përmes të gjithë aktorëve të përfshirë në proces	Të dhëna në kohë Qasje e të gjithë palëve të interesuara	Shtator 2024 – shtator 2025	KRL-ja e Komunës së Butelit
Str.3: Fillimi i nismës për Qendrën Informative Rinore				
Përcaktimi i lokacionit	Zyrë funksionale	Vendndodhja e zyrës	Janar – dhjetor 2024	KRL-ja e Komunës së Butelit
Përpilimi i një plani të punës	Sjellja e planit të punës	Monitorimi dhe vlerësimi i planit	Tetor-dhjetor 2016	KRL-ja e Komunës së Butelit

Qëllimi specifik nr. 2

Përdorimi i platformave dhe aplikacioneve të internetit për telefonat inteligjentë si një mjet për informimin e të rinjve

Strategjitë dhe aktivitetet	Rezultati i pritur	Treguesi	Korniza kohore	Përgjegjës
Str.1: Përdorimi i internetit dhe krijimi i një aplikacioni të përshtatshëm për informim				
Krijimi i një faqeje informacioni për informimin e të rinjve	Faqe informacioni funksionale	Numri i informacioneve të shpërndara Numri i frekuentimit	Mars – shtator 2024	Komuna e Butelit KRL-ja e Komunës së Butelit
Krijimi i bazës së të dhënave për OJQ-të dhe grupet joformale, ekipet sportive, të cilët veprojnë në territorin e komunës	Veprim i përbashkët i komunës dhe organizatave	Numri i organizatave dhe grupeve joformale të përfshira	Shtator 2024 – janar 2025	Komuna Këshilli i të Rinjve
Str.1: Krijimi i profileve të posaçme të fejsbukut, instagramit dhe tiktokut				
Faqja e Fejsbukut e KRL-së së Komunës së Butelit	Faqe funksionale e Fejsbukut, Instagramit dhe Tiktokut	Frekuentimi i faqes nga të rinjtë	Janar 2024	KRL-ja e Komunës së Butelit
Str.2: Mbajtja dhe përditësimi i të dhënave dhe informacioneve				
Profile aktive	Zhvillimi i një plani komunikativ të Komunës së Butelit për t'i përcjellë informacionet të rinjtë	Numri i anëtarëve/ ndjekësve Temat e përmajtjes Aktiviteti i të rinjve/ komentet/ mendimet		Qendra Informative Rinore KRL-ja e Komunës së Butelit

GJETJET E ANALIZËS SË REALIZUAR PËR NEVOJAT E TË RINJVE NË KOMUNËN E BUTELIT


Analiza e të dhënave të kërimit sasior

Hulumtimi sasior është realizuar përmes një ankete onlajn, aktive në periudhën 14 janar – 1 mars 2023, në të cilin kanë marrë pjesë 231 të anketuar nga Komuna e Butelit, nga mosha 15 deri në 29 vjeç.

Pyetjet e parashtuara synojnë të shqyrtojnë qëndrimet dhe perceptimet e të rinjve, në nëntë fusha tematike parësore:


- Arsimi
- Punësimi dhe mbështetja para punësimit
- Informimi i të rinjve
- Pjesëmarrja e të rinjve
- Sporti
- Shëndetësia
- Cilësia e të jetuarit
- Kultura
- Puna rinore lokale

Gjinia




Gjithsej 231 të anketuar janë përfshirë në hulumtim, nga të cilët 101 ishin meshkuj dhe 130 ishin femra.

Mosha




Numri më i madh i të anketuarve ishte nga grupmosha 15-18 vjeç, pra 58%, pasuar nga 23,8% nga 19-24 vjeç dhe 18,2% nga 25-29 vjeç.

Shkalla e arsimit




Sa i përket nivelit të arsimit, 2.2% janë “me arsim deri në fillore”, 28.1% “me arsim fillor”, 41.6% “me arsim të mesëm”, 26.8% janë “me arsim të lartë” (studime diplomike) dhe 1.3% janë “me arsim të lartë” (studime pasdiplomike/doktoraturë).

Përkatësia etnike




Sa i përket përkatësisë etnike të të anketuarve – 52.4% janë maqedonas, 39.8% shqiptarë, 1.3% turq, 0.9% romë, 2.6% boshnjakë, 1.7% serbë, 0.9 vllah dhe 0.4% të ndonjë tjetër përkatësie etnike.

Profesioni



55,8 % од испитаниците се ученици, 16,9 % студенти, 21,7% вработени и 4,3 % се невработени.

Vendbanimi



70.6% e të anketuarve jetojnë në mjedis urban, ndërsa 29.4% jetojnë në mjedis rural.

Fusha tematike - Arsimi

Në shkallën 1 (më e keqja) - 5 (më e mira), si do ta vlerësonit cilësinë e arsimit në Komunën e Butelit?			
		Të anketuar	Përqindja
	1	16	6,9
	2	19	8,2
	3	73	31,6
	4	60	26
	5	48	20,8
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	15	6,5
	Gjithsej	231	100

Në këtë pyetje, të anketuarit vlerësuan cilësinë e arsimit në kuadër të komunës, dhe kështu u arrit një perceptim i përgjithshëm për këtë çështje. Nota mesatare e kësaj pyetje është 3.25.

Sipas jush, sistemi arsimor a ofron përvetësim të aftësive praktike për punësim të mundshëm më të lehtë?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	24	10;4
	Deri diku po	83	35,9
	Deri diku jo	38	16;5
	Jo	66	28,6
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	20	8;7
	Gjithsej	231	100

Për sa i përket faktit nëse sistemi arsimor ofron përvetësimin e aftësive praktike për punësim më të lehtë, të anketuarit kishin mendim të ndarë. Përkatësisht, 46.3% japin mendim pozitiv për këtë çështje, ndërsa 45.1% mendim negativ.

Duke marrë parasysh arsimimin tuaj, a mendoni se do të gjeni lehtësisht punë?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	56	24.2
	Deri diku po	78	33.8
	Deri diku jo	26	11.3
	Jo	46	19.9
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	25	10.8
	Gjithsej	231	100.0

Shumica e të anketuarve, gjegjësisht 58% besojnë se do të gjejnë punë lehtësisht me arsimin e tyre, ndërsa një pjesë më e vogël gjegjësisht 31.2% kanë shprehur të kundërtën.

Sipas jush, cili është problemi më i madh me të cilin ballafaqohen shkollat në Komunën e Butelit?		
	Të anketuar	Përqindja
Mungesa e kuadrit përkatës mësimor	38	16.5
Klasat dhe pajisjet shkollore të vjetruara	34	14.7
Raporti i papërshtatshëm i mësuesve ndaj nxënësve	4	1.7
Raporti i papërshtatshëm i nxënësve ndaj mësuesve	32	13.9
Padurim ndërmjet nxënësve/sjellje e pakënaqshme	12	5.2
Mungesa e pajisjeve kompjuterike	13	5.6
Përdorimi i celularëve gjatë orës së mësimi	32	13.9
Mësimdhënie praktike jo të duhur	21	9.1
Programe mësimore jo të duhur	4	1.7
Mungesa e mbështetjes nga autoritetet për zhvillimin e arsimit dhe institucioneve arsimore	16	6.9
Tjetër	5	2.2
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	20	8.7
Gjithsej	231	100.0

Në pyetjen se cili është problemi më i madh në shkollë, kemi disa përgjigje të mundshme, nga të cilat problemet më të mëdha janë: mungesa e kuadrit përkatës mësimor me 16.5%, klasat dhe pajisjet shkollore të vjetruara me 14.7%, raporti i papërshtatshëm i nxënësve ndaj mësuesve me 13,9%, përdorimi i celularëve gjatë orës së mësimi me 13,9%, si dhe mësimi praktik jo i duhur me 9,1%. Nga të gjitha përgjigjet e parashikuara, arsyet e lart-përmendura janë treguar në përqindjen më të madhe.

Përfundimi dhe rekomandime nga hulumtimi sasior – Arsimi

- Vlerësimi mesatar relativisht i ulët për cilësinë e arsimit nga të anketuarit – 3.25
- Ndarja për çështjen e mësimdhënies praktike cilësore dhe nevojën për mësimdhënie praktike më të mirë
- Nevoja për të përmirësuar situatën me kuadrin mësimdhënës, klasat dhe pajisjet shkollore, sjelljen e nxënësve, përdorimin e celularëve gjatë orës së mësimi

Fusha tematike – Punësimi dhe mbështetja para punësimit

A keni qenë ndonjëherë i/e punësuar?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	90	39.0
	Jo	125	54.1
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	16	6.9
	Gjithsej	231	100.0

Deri më tani, 39% e të anketuarve kanë qenë të punësuar, ndërsa 54,1% janë përgjigjur se nuk kanë punuar kurrë.

A jeni aktualisht i/e punësuar?			
		Të anketuar	Përgjigje
	Po	61	26.4
	Jo	29	12.6
*deri tani nuk ka qenë i/e punësuar he ND/NP në pyetjen paraprake		141	61.0
Gjithsej		231	100.0

Aktualisht, 26.4% e të anketuarve janë të punësuar, dhe 12.6% nuk janë të punësuar. Të anketuarit e mbetur nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje, sepse nuk ishin të punësuar deri më tani.

A keni arritur të gjeni punë lehtësisht?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	37	41,1
	Jo	43	47,8
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	10	11,1
	Gjithsej	90	100,0

Nga të anketuarit që kanë qenë të punësuar deri më tani, 16% janë përgjigjur se kanë arritur të gjejnë punë lehtësisht, ndërsa 18.6% nuk kanë arritur të gjejnë punë lehtë.

Sipas jush, cila është mënyra më e lehtë për të gjetur punë?			
		Të anketuar	Përqindja
	Me arsimim/aftësi/kualifikime	71	30.7
	Me përvojë pune relevante	22	9.5
	Me lidhje miqësore dhe familjare	55	23.8
	Me anëtarësim në parti politike	43	18.6
	Me trajnime dhe parakualifikim	6	2.6
	Me vetëpunësim dhe hapje të biznesit personal	13	5.6
	Tjetër	10	4.3
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	11	4.8
	Gjithsej	231	100.0

Shumica e të anketuarve, pra 30,7% besojnë se është më e lehtë të gjejsh një punë me arsimin dhe aftësitë e duhura, 23,8% besojnë se është më e lehtë me lidhje miqësore dhe familjare, dhe 18,6% besojnë se punë gjendet me anëtarësim në parti politike.

Sipas jush, a ofrojnë autoritetet lokale mbështetje për të papunët nëpërmjet programeve, trajnimeve dhe mundësive për të fituar aftësi të reja?			
Të anketuar		Përqindja	Процент
32	13.9	32	13,9
	119	51.5	51,5
	80	34.6	34,6
	231	100.0	100

51.5% e të anketuarve mendojnë se autoritetet lokale nuk ofrojnë mbështetje për të papunët përmes programeve, trajnimeve etj., ndërsa 13.9% besojnë se komuna i ofron këto mundësi.

A keni ndjekur ndonjëherë ndonjë trajnim në komunën tuaj për të fituar aftësi të reja që ju kanë ndihmuar në zhvillimin tuaj të mëtejshëm profesional?

		Të anketuar	Përqindja
	Po	42	18.2
	Jo	166	71.9
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	23	10.0
	Gjithsej	231	100.0

Shumica e të anketuarve, 71.9%, deri më tani nuk kanë ndjekur trajnime për aftësi të reja të organizuara nga komuna, ndërsa 18.2% kanë ndjekur trajnime të atij lloji.

Nëse ka mundësi, a do të përfshihehit në trajnime për të zhvilluar aftësitë digjitale si parakusht për një biznes të suksesshëm?

		Të anketuar	Përqindja
	Po	173	74.9
	Jo	28	12.1
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	30	13.0
	Gjithsej	231	100.0

74.9% e të anketuarve deklaruan se do të dëshironin të ndiqnin trajnime për aftësitë digjitale, ndërsa 12.1% nuk do të merrnin pjesë në një trajnim të tillë.

Përfundim dhe rekomandime nga hulumtimi sasior – Punësimi dhe mbështetja para punësimit

- Një përqindje e lartë e të anketuarve që besojnë se punësimi gjendet nëpërmjet miqësisë dhe lidhjeve familjare si dhe anëtarësimit në parti politike.
- Nevoja për organizimin e trajnimeve për përvetësimin e aftësive të reja nga autoritetet lokale.
- Interes i lartë për trajnime në fushën e aftësive digjitale.

Fusha tematike – Pjesëmarrja e të rinjve dhe informimi i të rinjve

Si qëndroni të informuar për të gjitha ngjarjet aktuale që janë me interes personal për ju si i ri?			
		Të anketuar	Përqindja
	Televizori	13	5.6
	Portale të internetit	41	17.7
	Rrjete sociale (Fejsbuk, Instagram, Tuiitter, Tiktok)	156	67.5
	Bisedë me miq/familjarë	12	5.2
	Përmes bashkësisë sime fetare (KOM, BFI etj.)	1	.4
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	8	3.5
	Gjithsej	231	100.0

Shumica e të rinjve informohen onlajn, përkatësisht 17.7% në portalet e internetit dhe 67.5% nëpërmjet rrjeteve sociale.

Për çfarë lloj informacioni jeni më të interesuar?			
		Të anketuar	Përqindja
	Informacione të karakterit argëtues	45	19.5
	Informacione nga fusha e kulturës	25	10.8
	Informacione nga fusha e ekonomisë dhe biznesit	34	14.7
	Informacione rreth zhvillimeve shoqërore dhe politike në vend	33	14.3
	Informacione rreth ngjarjeve në botë	38	16.5
	Informacione nga fusha e sportit	30	13.0
	Tjetër	18	7.8
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	8	3.5
	Gjithsej	231	100.0

Informacionet me karakter argëtues me 19,5%, ngjarjet botërore me 16,5%, ekonomia dhe biznesi me 14,7%, zhvillimet shoqërore dhe politike në vend me 14,3%, sporti me 13%, dhe kultura me 10,8% janë ato që të rinjtë janë më të interesuar.

A keni marrë ndonjëherë pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe/ose shtetëror?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	56	24.2
	Jo	145	62.8
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	30	13.0
	Gjithsej	231	100.0

Shumica e të rinjve, pra 62.8%, janë përgjigjur se deri më tani nuk kanë marrë pjesë aktive në vendimmarrje. Ndërsa 24.2% kanë marrë pjesë deri më tani në këtë proces.

Në çfarë mënyre merrni/keni marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal apo shtetëror?			
		Të anketuar	Përqindja
	Anëtarësim në organizatë rinore/të shkollës së mesme/studentore	20	8,7
	Anëtarësim në organizatë joqeveritare	12	5,2
	Anëtarësim në parti politike	15	6,5
	Përmes propozimeve me grup qytetarësh	1	0,4
	Duke kontaktuar autoritetet komunale	3	1,3
	Përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me politikanë	5	2,2
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	56	24,2
	*Nuk kanë marrë pjesë	175	75,8
	Gjithsej	231	100

8.7% e të anketuarve kanë marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes përmes anëtarësimit në organizata rinore dhe shkollore, 6.5% përmes anëtarësimit në parti politike, 5.2% përmes anëtarësimit në OJQ.

A jeni informuar ndonjëherë për ndonjë mundësi për të rinjtë që ofrojnë format e organizimit rinor?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	90	39.0
	Jo	121	52.4
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	20	8.7
	Gjithsej	231	100.0

52.4% e të anketuarve nuk janë të informuar për mundësitë që të rinjtë mund t'i marrin përmes formave të organizimit të të rinjve, ndërsa 39% janë të njohur me këto mundësi.

Sipas jush, cili është problemi më i madh në Komunën e Butelit?

	Të anketuar	Përqindja
Arsimi (shkollat dhe çerdhet)	21	9.1
Komunikacioni	8	3.5
Parkingu	9	3.9
Ndotja e ajrit	20	8.7
Mbeturinat dhe higjiena	39	16.9
Infrastruktura (rrugë dhe trotuare)	26	11.3
Ekologjia dhe mjedisi jetësor	22	9.5
Parqet dhe hapësirat e gjelbra	26	11.3
Krimi dhe korrupsioni	31	13.4
Mafia urbane dhe ndërtimet pa leje	15	6.5
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	14	6.1
Gjithsej	231	100.0

Mbeturinat dhe higjiena me 16,9% paraqiten si problemi më i madh në Komunën e Butelit, pasuar nga krimi dhe korrupsioni me 13,4%, infrastruktura me 11,3%, parqet dhe hapësirat e gjelbra me 11,3%, ekologjia dhe mjedisi jetësor me 9,5%, arsimi me 9,1%, ndotja e ajrit me 8.7%, etj.

Cili është problemi i dytë më i madh në Komunën e Butelit?

	Të anketuar	Përqindja
Arsimi (shkollat dhe çerdhet)	17	7.4
Komunikacioni	12	5.2
Parkingu	12	5.2
Ndotja e ajrit	32	13.9
Mbeturinat dhe higjiena	28	12.1
Infrastruktura (rrugë dhe trotuare)	35	15.2
Ekologjia dhe mjedisi jetësor	25	10.8
Parqet dhe hapësirat e gjelbra	15	6.5
Krimi dhe korrupsioni	14	6.1
Mafia urbane dhe ndërtimet pa leje	22	9.5
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	19	8.2
Gjithsej	231	100.0

Problemi i dytë më i madh është infrastruktura me 15,2%, ndotja e ajrit me 13,9%, mbetjet dhe higjiena me 12,1%, ekologjia dhe mjedisi jetësor me 10,8%, mafia urbane dhe ndërtimet pa leje me 9,5% etj.

Cilat janë nevojat e të rinjve nga zonat rurale në Komunën e Butelit?

	Të anketuar	Përqindja
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	176	76.2
Ekonomia	7	3.0
Infrastruktura	8	3.5
Transporti publik	15	6.5
Kultura	3	1.3
Arsimi	2	.9
Parqet dhe gjelbërimet	4	1.7
Jeta sociale	1	.4
Fushat sportive dhe palestrat sportive	13	5.6
Shkollat	2	.9
Gjithsej	231	100.0

Nevojat më të mëdha të të rinjve nga zonat rurale të komunës janë transporti publik me 6,5%, fushat sportive dhe palestrat sportive me 5,6%, etj.

Pyetja në vijim është e hapur dhe të anketuarit kanë dhënë përgjigjet vijuese:

Në përgjithësi, cilat janë propozimet dhe rekomandimet tua për pushtetin lokal në Komunën e Butelit?

	Të anketuar	Përqindja
Nuk e di/ nuk ka përgjigje	161	69.7
Përditësim	1	.4
Ambulancë	2	.9
Stacione të autobusëve	1	.4
Siguri	1	.4
Bibliotekë	1	.4
Të punojnë me ndershmëri	1	.4
Disponueshmëri	1	.4
Ekologji	1	.4
Ekonomi	1	.4
Çerdhe	1	.4
Higjienë	3	1.3
Infrastrukturë	11	4.8
Transport publik	1	.4
Korrupsion	2	.9

Qentë endacakë	2	.9
Kulturë	3	1.3
Politika rinore	15	6.5
Arsim	1	.4
Parking	1	.4
Parqe dhe gjelbrime	5	2.2
Rend	2	.9
Zhvillim rural	1	.4
Bashkëjetesë	1	.4
Komunikacion	1	.4
Fusha sportive dhe palestra sportive	5	2.2
Bursa	1	.4
Qendra tregtare	1	.4
Shkolla	2	.9
Ujësjetës dhe kanalizim	1	.4
Gjithsej	231	100.0

Përfundimi dhe rekomandime nga hulumtimi sasior - Pjesëmarrja e të rinjve dhe informimi i të rinjve

- Shumica e të anketuarve informohen onlajn, pra përmes portaleve të internetit dhe rrjeteve sociale. Për të gjitha aktivitetet e ardhshme lidhur me politikat rinore në komunë, mënyra më efektive e informimit të të rinjve do të ishte shkëmbimi i informacionit onlajn.
- Shumica e të anketuarve nuk marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe shtetëror.
- Higjiena, nevoja për parqe, ekologjia dhe mjedisi i pastër jetësor tregohen si problemet më të mëdha në komunën e Butelit.

Fusha tematike - Sporti

A merreni me sport?		Të anketuar	Përqindja
Po		149	64.5
Jo		79	34.2
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje		3	1.3
Gjithsej		231	100.0

Shumica e të anketuarve kanë deklaruar se merren me sport, përkatësisht 64.5%.

A jeni të kënaqur me gjendjen e palestrave sportive dhe këndeve të lojërave në Komunën e Butelit?		Të anketuar	Përqindja
Po		99	42.9
Jo		93	40.3
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje		39	16.9
Gjithsej		231	100.0

Shumica e të anketuarve janë të kënaqur me palestrat sportive - 42,9%, ndërsa 40,3% janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur.

A investojnë autoritetet komunale në zhvillimin e sportit dhe shprehive sportive të të rinjtë?		Të anketuar	Përqindja
Po		70	30.3
Pjesërisht		105	45.5
Jo		36	15.6
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje		20	8.7
Gjithsej		231	100.0

Shumica e të anketuarve konsiderojnë se pushteti lokal investon ose pjesërisht investon në zhvillimin e sportit dhe shprehive sportive, përkatësisht 75.8% e të anketuarve.

Sipas jush, çfarë duhet të bëjnë autoritetet komunale për të rritur numrin e të rinjve që merren me sport?

	Të anketuar	Përqindja
Ndërtimi i palestrave të reja sportive dhe këndeve sportive	61	26,4
Ndërtimi i pishinave për not	35	15,2
Subvencionimi i kartave të anëtarësimit të klubeve sportive për të rinjtë	22	9,5
Subvencionimi i pajisjeve sportive dhe rekuizitave sportive	15	6,5
Promovimi dhe fushata për përfitimet nga sporti	6	2,6
Edukimi që në moshë të vogël për rëndësinë e sportit	43	18,6
Avancimi i bashkëpunimit të klubeve dhe shoqatave sportive me shkollat	16	6,9
Përfshirja aktive e të rinjve në krijimin e politikave lidhur me sportin	12	5,2
Tjetër	7	3
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	14	6,1
Gjithsej	231	100

26,4 nga të anketuarit besojnë se ndërtimi i sallave të reja sportive dhe këndeve të lojërave do të rriste numrin e të rinjve që merren me sport, 18,6% besojnë se është edukimi që në moshë të vogël dhe 15,2% besojnë se ndërtimi i pishinave do të kontribuonte për këtë, 9.5% e të anketuarve mendojnë se subvencionimi i kartave të anëtarësimit nga klubet sportive do të ishte gjithashtu i mirë për rritjen e sportit dhe kulturës sportive.

Përfundime dhe rekomandime nga hulumtimi sasior - Sporti

- Pjesa më e madhe e të anketuarve shprehen të kënaqur me investimin në kapacitetet sportive nga ana e pushtetit lokal.
- Mbetet nevoja për investime shtesë në palestra sportive dhe fusha sportive në kuadër të komunës.
- Nevojitet edukim mbi rëndësinë e sportit dhe shprehive sportive.

Fusha tematike - Shëndetësia

Në shkallën 1 (më e keqja) - 5 (më e mira), si do ta vlerësonit cilësinë e shërbimeve shëndetësore në institucionet shëndetësore publike në territorin e Komunës së Butelit?

		Të anketuar	Përqindja
	1	37	16.0
	2	45	19.5
	3	85	36.8
	4	35	15.2
	5	12	5.2
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	17	7.4
	Gjithsej	231	100.0

Të anketuarit japin një vlerësim mesatar prej 2.52% për cilësinë e shërbimeve shëndetësore në objektet shëndetësore në komunë.

A shkoni në kontrolle të rregullta mjekësore?

		Të anketuar	Përqindja
	Po	152	65.8
	Jo	70	30.3
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	9	3.9
	Gjithsej	231	100.0

65.8% e të anketuarve kanë deklaruar se shkojnë në kontrolle të rregullta mjekësore, ndërsa 30.3% kanë deklaruar se nuk shkojnë në kontrolle të rregullta mjekësore.

A shkoni rregullisht për kontrolle gjinekologjike?

		Të anketuar	Përqindja
	Po	49	37.7
	Jo	71	54.6
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	10	7.7
	Gjithsej	130	100.0

37.7% e të anketuarve femra janë përgjigjur se shkojnë për kontrolle të rregullta gjinekologjike. 54.6% janë përgjigjur se nuk shkojnë për kontrolle të rregullta gjinekologjike.

A i ndiqni rekomandimet e mjekëve për një jetë të shëndetshme dhe ruajtjen e gjendjes së mirë shëndetësore?

	Të anketuar	Përqindja
Po	91	39.4
Deri diku po	119	51.5
Deri diku jo	12	5.2
Jo	5	2.2
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	4	1.7
Gjithsej	231	100.0

90.9% e të anketuarve deklaruan se ndjekin rekomandimet e mjekëve për një jetë të shëndetshme dhe ruajtjen e gjendjes së mirë shëndetësore.

Sipas jush, çfarë duhet të bëjë pushteti lokal për të ngritur vetëdijen për shprehitë e shëndetshme të jetesës dhe parandalimin e sëmundjeve?

	Të anketuar	Përqindja
Fushata të rregullta për ngritjen e vetëdijes publike te të gjithë qytetarët	49	21.2
Program edukativ në të gjitha shkollat	72	31.2
Kontrollime sistematike falas	80	34.6
Tjetër	15	6.5
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	15	6.5
Gjithsej	231	100.0

34.6% e të anketuarve konsiderojnë se kontrollimet sistematike falas do të kontribuojë në rritjen e vetëdijes për shprehitë e jetesës së shëndetshme dhe parandalimin e sëmundjeve, 31.2% besojnë se do të ishte një program edukativ në shkolla dhe 21.2% tregojnë për fushata të rregullta për ngritjen e vetëdijes publike, si diçka që pushteti lokal duhet të ndërmarë për këtë qëllim.

Përfundimi dhe rekomandime nga hulumtimi sasior – Shëndetësi

- Të anketuarit japin vlerësim mesatar relativisht të ulët – 2.52%, për cilësinë e shërbimeve shëndetësore në objektet shëndetësore në komunë
- Vetëm rreth një e treta, pra 37.7% e të anketuarve femra kanë deklaruar se shkojnë për kontrole të rregullta gjinekologjike.
- Kontrollimet sistematike falas, programet edukative dhe fushatat e rregullta do të ngritin vetëdijen publike për t'u kujdesur për shëndetin e vet.

Fusha tematike – Cilësia e të jetuarit

Si e vlerësoni ju si i ri/ e re cilësinë e të jetuarit në Komunën e Butelit?			
		Të anketuar	Përqindja
	Mirë	45	19.5
	Deri diku mirë	112	48.5
	Deri diku keq	41	17.7
	Keq	26	11.3
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	7	3.0
	Gjithsej	231	100.0

68% e të anketuarve kanë perceptim pozitiv për cilësinë e të jetuarit në Komunën e Butelit.

Cilat nga arsyet e mëposhtme do të përmendnit si më të rëndësishmet për përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve?			
		Të anketuar	Përqindja
	Punësimi dhe standardi jetësor	61	26.4
	Ekologjia dhe mjedisi jetësor	11	4.8
	Arsimi dhe mundësia për avancim profesional	22	9.5
	Futja e sistemit të meritave (sistemi i avancimit sipas meritave)	8	3.5
	Jeta sociale dhe shoqërimi	27	11.7
	E drejta e lirisë së shprehjes	15	6.5
	Lufta kundër diskriminimit	14	6.1
	Lufta kundër krimit dhe korrupsionit	21	9.1
	Mundësia për sport dhe rekreacion	7	3.0
	Përfshirja aktive e të rinjve në punën a pushtetit lokal dhe qendror	7	3.0
	Edukimi shtëpiak	17	7.4
	Shëndetësia dhe kujdesi shëndetësor	1	.4
	Gjyqësori dhe sistemi gjyqësor efikas	1	.4
	Sektori publik efikas	1	.4
	Kultura dhe argëtimi	8	3.5
	Tjetër	1	.4
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	9	3.9
	Gjithsej	231	100.0

Punësimi dhe përmirësimi i standardit të të jetuarit është një nga arsyet më të zakonshme që të anketuarit besojnë se do të përmirësonte cilësinë e jetës së tyre. Më pas vijon jeta shoqërore, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, lufta kundër diskriminimit, si dhe përfshirja e të rinjve në punën e pushtetit lokal dhe qendror.

A ndiheni të sigurt në Komunën e Butelit?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	59	25.5
	Deri diku po	98	42.4
	Deri diku jo	32	13.9
	Jo	39	16.9
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	3	1.3
	Gjithsej	231	100.0

67.9% e të anketuarve kanë deklaruar se ndihen të sigurt ose deri diku të sigurt në komunën e Butelit, ndërsa 30.8% nuk ndihen ose deri diku nuk ndihen të sigurt.

Për çfarë arsye nuk ndiheni të sigurt?			
		Të anketuar	Përqindja
	Nuk ka përgjigje/ Ndihen të sigurt	157	68.0
	Diskriminimi	1	.4
	Krimi/grupet kriminale	22	9.5
	Qentë endacakë	11	4.8
	Jo toleranca ndëretnike	7	3.0
	Shqetësimi	1	.4
	Nacionalizmi	1	.4
	Dhuna	4	1.7
	Nuk ndihem i/e sigurt	1	.4
	Nuk ka trotuare	1	.4
	Skamje	1	.4
	Nuk kemi të drejta	3	1.3
	Rrugë të pandriçuara	4	1.7
	Komunikacion i parregulluar	2	.9
	Armë pa leje	5	2.2
	Policia nuk është efikase	3	1.3
	Provokime	1	.4
	Polemika	2	.9

Komunikacioni	1	.4
Mafia urbane	2	.9
Ndotja	1	.4
Gjithsej	231	100.0

Krimi dhe grupet kriminale, qentë endacakë, jo toleranca ndëretnike, posedimi i armëve pa leje dhe joefikasiteti policor janë ndër arsyet që të anketuarit më së shpeshti i tregojnë si arsye pse ata nuk ndihen të sigurt.

A mendoni se mund të bëheni të pavarur si i ri/ e re?		
	Të anketuar	Përqindja
Po	131	56.7
Jo	63	27.3
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	37	16.0
Gjithsej	231	100.0

56,7% e të anketuarve mendojnë se mund të bëhen të pavarur si të rinj, ndërsa 27,3% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk mendojnë se mund të bëhen të pavarur.

A mendoni se Komuna e Butelit ka politika të mira që prekin të rinjtë?		
	Të anketuar	Përqindja
Po	61	26.4
Jo	95	41.1
Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	75	32.5
Gjithsej	231	100.0

26.4% e të anketuarve mendojnë se Komuna e Butelit ka politika të mira për të rinjtë, ndërsa 41.1% nuk mendojnë se komuna ka politika të mira.

Përfundimi dhe rekomandime nga hulumtimi sasior - Cilësia e të jetuarit

- Shumica e të rinjve kanë perceptim pozitiv për cilësinë e të jetuarit në Komunën e Butelit.
- Përmirësimi i standardit të jetesës dhe lufta kundër krimit dhe korrupsionit, si dhe kushtet për jetë sociale dhe shoqërim, janë disa nga gjërat që duhen përmirësuar.
- Krimi, grupet kriminale, qentë endacakë, jo toleranca ndëretnike dhe efikasiteti policor janë tema të cilave duhet t'i kushtohet vëmendje, si dhe përmirësimi i kushteve në ato zona.

Fusha tematike - Kultura

Si do ta vlerësonit gjendjen e kulturës dhe ofertës kulturore në Komunën e Butelit?			
		Të anketuar	Përqindja
	Mirë	40	17.3
	Deri diku mirë	77	33.3
	Deri diku keq	46	19.9
	Keq	45	19.5
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	23	10.0
	Gjithsej	231	100.0

Ekziston një ndarje në mesin e të anketuarve lidhur me pikëpamjet e tyre për gjendjen e kulturës dhe ofertës kulturore në Komunën e Butelit. Përgjithësisht ekziston një perceptim negativ ose disi negativ i kushteve në këtë zonë.

Cili është problemi më i madh në fushën e kulturës dhe ofertës kulturore për të rinjtë në Komunën e Butelit?			
		Të anketuar	Përqindja
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	182	78.8
	Biblioteka	1	.4
	Diskriminimi	2	.9
	Qendra rinore dhe kulturore	2	.9
	Nuk punohet në atë drejtim	11	4.8
	Nuk ka skenë alternative	1	.4
	Nuk ka bare dhe restorante	1	.4
	Nuk ka ku të organizohen ngjarje	2	.9
	Nuk ka ofertë kulturore	27	11.7
	Nuk ka teatër	2	.9
	Gjithsej	231	100.0

Problemi më i madh është mungesa e ofertës kulturore dhe mungesa e aktiviteteve për përmirësimin e gjendjes me kulturën.

Në përgjithësi, në çfarë lloj aktiviteteve kulturore merrni pjesë apo dëshironi të merrni pjesë?		Të anketuar	Përqindja
	Koncerte muzikore	46	19.9
	Shfaqje teatrale	32	13.9
	Ekspozita të veprave artistike (pikturë, skulpturë etj.)	6	2.6
	Festivale muzikore	41	17.7
	Lexime poetike	9	3.9
	Shfaqje kinemash	36	15.6
	Valle	9	3.9
	Vizita në muze	10	4.3
	Tjetër	19	8.2
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	23	10.0
	Gjithsej	231	100.0

Koncertet muzikore, festivalet, shfaqjet teatrale dhe shfaqjet e kinemasë janë ndër ngjarjet që të anketuarit më shumë pëlqejnë/do të donin të vizitonin.

Sipas jush, çfarë duhet të ndërmarrin autoritetet lokale për të përmirësuar fushën e kulturës dhe ofertën kulturore brenda Komunës së Butelit?			Të anketuar	Përqindja
	Mbështetje për futjen e lëndëve figurative dhe dramatike në shkollë		26	11.3
	Bashkëpunim aktiv me të gjithë individët dhe organizatat në fushën e kulturës		35	15.2
	Organizimi i manifestimeve kulturore nën patronazhin e Komunës së Butelit		76	32.9
	Hyrja falas për të rinjtë/çmime të reduktuara të biletave për të rinjtë		68	29.4
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje		26	11.3
	Gjithsej		231	100.0

Organizimi i ngjarjeve kulturore, hyrja falas apo çmimet e reduktuara të biletave për të rinjtë dhe bashkëpunimi i mbështetja aktive me përfaqësues nga fusha e kulturës janë drejtimet që të anketuarit konsiderojnë se duhen marrë për përmirësime në këtë fushë.

Përfundimi dhe rekomandime nga hulumtimi sasior – Kulturë

- Shumica e të rinjve kanë një perceptim negativ për kulturën dhe ofertën kulturore në komunën e Butelit.
- Është e nevojshme të organizohen manifestime kulturore, koncerte, festivale dhe ngjarje të tjera në fushën e kulturës.

Fusha tematike – Puna lokale rinore

A jeni njohur me konceptin e punës lokale rinore?			
		Të anketuar	Përqindja
	Po	37	16.0
	Jo	173	74.9
	Nuk e di/ Nuk ka përgjigje	21	9.1
	Gjithsej	231	100.0

Konkluzioni dhe rekomandimet nga hulumtimi sasior - Puna lokale rinore

- Shumica e të rinjve nuk e njohin konceptin e PLR-së
- Është e nevojshme të punohet për informimin e të rinjve për këtë koncept.

Analiza e të dhënave nga hulumtimi cilësor – grupet e fokusit

Intervistat e grupeve të fokusit u zhvilluan në platformën online ZOOM. Intervista e parë e fokus grupit u mbajt më 1 mars 2023, e dyta më 9 mars 2023 dhe e treta më 17 mars 2023.

Hulumtimi cilësor u krye duke realizuar tre grupe të fokusit me disa grupe të synuara:

- të rinj (15 -29 vjeç)
- përfaqësues të kuadrit mësimor nga shkollat fillore dhe të mesme në komunë
- përfaqësues të organizatave rinore dhe përfaqësues të Komunës së Butelit.
- Në fokus grupet, pjesëmarrësit u ftuan si pjesë e tre grupeve të synuara, me qëllim marrjen e informacionit përmes një procesi të stimulimit të ideve me njëri-tjetrin. Intervistat e fokus grupeve u zhvilluan në platformën online ZOOM. Intervista e parë e fokus grupit u mbajt më 1 mars 2023, e dyta më 9 mars 2023 dhe e treta më 17 mars 2023. Gjithsej 18 pjesëmarrës nga grupet e synuara të mësipërme morën pjesë në fokus grupe.

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e arsimit

- Të rritet vëllimi i stafit mësimdhënës të punësuar
- Të rinovohen shkollat
- Të përmirësohet furnizimi me libra dhe materiale mësimore në shkolla
- Të ndërmerren aktivitete parandaluese për të parandaluar jo tolerancën ndëretnike ndërmjet nxënësve
- Të ndahet një buxhet më i madh për shkollat
- Të përmirësohet higjiena në shkolla
- Shkollat duhet të pajisen më mirë në drejtim të mësimdhënies së digjitalizuar

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e punësimit dhe mbështetjes para punësimit

Të ofrohet mbështetje për të rinjtë në procesin e kërkimit të punës

- Të reduktohet pjesëmarrja në procesin e punësimit
- Të ofrohen më shumë mundësi për të rinjtë për të fituar përvojë pune
- Të mbahen trajnime për vetëpunësim

- Të sigurohen më tepër mësim praktikë
- Të organizohen aktivitete që nxisin rrjetëzimin e punës mes të rinjve
- Të krijohet një fond për të rinjtë
- Arsimi i mesëm profesional

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e pjesëmarrjes së të rinjve dhe informimit të të rinjve

- Përfshirje më e madhe sociale dhe politike e të rinjve
- Disponueshmëri më e madhe e informacionit përmes kanaleve të informacionit të përdorura nga të rinjtë

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e sportit

- Të ndërtohet pishinë
- Të ndërtohen më shumë shtigje biçikletash
- Të rinovohen palestrat dhe rekuizitorët
- Të ofrohen më shumë mundësi për aktivitete sportive
- Të organizohen më shumë gara ndërmjet shkollave fillore dhe të mesme

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e shëndetit

- Të organizohen më shumë fushata dhe reklama për të ngritur vetëdijen për shëndetin dhe sëmundjet e caktuara
- Të edukohen të rinjtë për kujdesin ndaj shëndetit riprodhues
- Të zbatohen programe edukative për nxitjen e shprehive të shëndetshme në shkollat fillore dhe të mesme
- Të edukohen të rinjtë për rreziqet e pirjes së duhanit dhe alkoolit
- Të ngritet vetëdija dhe të edukohen të rinjtë për rëndësinë e shëndetit mendor
- Parandalimi shëndetësor: kontrole të rregullta dentare dhe kontrole sistematike

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike cilësia e jetës

- Siguria dhe marrëdhëniet ndëretnike theksohen si problematike:
- Të rritet niveli i sigurisë lokale, duke zbatuar më shumë kontrolle nga MPB-ja
- Të ndërtohet infrastrukturë për biçikleta
- Të parandalohet dhuna ndëretnike në hapësirat publike
- Të vendoset ndalimi i armëmbajtjes pa leje
- Të rritet numri dhe shumëllojshmëria e mundësive për jetën sociale të të rinjve

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e kulturës

Nuk ka asnjë ofertë kulturore dhe për këtë arsye propozohen idetë në vijim:

- Të hapet qendër kulturore
- Të organizohet kinema dhe/ose teatër në natyrë
- Të themelohet festival i artit figurativ në Lubancë
- Të krijohet një vendgrumbullimi për të rinjtë, duke ndjekur shembullin e Guaskës në Parkun e Qytetit
- Të organizohen ngjarje letrare dhe artistike figurative

Përfundime dhe rekomandime nga fusha tematike e punës rinore lokale

- Inkurajimi i pjesëmarrjes së të rinjve në vetëqeverisjen lokale
- Inkurajimi i të rinjve për të ndërmarrë më shumë aktivitete vullnetare dhe qytetare

Grupi i Punës

Lista e pjesëmarrësve në grupin e punës

Për përpilimin e dokumentit “Strategjia lokale për të rinjtë e Komunës së Butelit 2023-2028”, u formua grup i punës, i cili përbëhej nga:

- Mariglen Demiri, koordinator i projektit “Komuna e Butelit, e hapur për të rinjtë”
- Mihajllo Talevski, fasilitator (ndihmës) dhe hulumtues
- Ebru Emini, Zyra për të rinjtë në Komunën e Butelit
- Danijaer Vellkovski, kandidat për Këshillin Rinor Lokal
- Marija Spasencovska, kandidate për Këshillin Rinor Lokal
- Martina Pavličkova, kandidate për Këshillin Rinor Lokal
- Tea Todorovska, kandidate për Këshillin Rinor Lokal
- Nikolla Stojkovski
- Stefan Kolloshv
- Damjan Naumovski
- Mishella Nallbantova
- Teodora Spasencovska
- Hristijan Perçinkovski
- Enez Emini
- Adrijana Vellkovska
- Damjan Vellkovski
- Jakov Avramovski
- Tea Todorovska
- Ensar Memedi
- Isa Zekiri
- Ivan Aleksovski
- Leonid Pavllovski
- Sofija Tasevska

Koordinatorët e realizimit të “Strategjisë lokale për të rinjtë të Komunës së Butelit 2023-2028”

- Ebru Emini, Zyra për të rinj
- Mariglen Demiri, Koordinator i projektit “Komuna e Butelit, e hapur për të rinjtë”
- Mihajllo Talevski, fasilitator (ndihmës)



Проектот е финансиран
од Европската Унија

